



Влада на Република Северна Македонија  
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

-SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM-

Në bazë të nenit 7 të Vendimit për formimin e Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 98/16 dhe 164/17 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 97/19 dhe 116/21), Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon

**RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË dhe  
THIRRJE PUBLIKE PËR VOTIM**  
**për zgjedhjen anëtar të Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile nga  
radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën Mbrojtja e mjedisit jetësor**

**I. RAPORT PËR ORGANIZATAT E PARAQITURA ME KANDIDATË**

Në bazë të Thirrjes Publike për zgjedhjen anëtar të Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën Mbrojtja e mjedisit jetësor, publikuarmë 3.11.2021, në faqet e internetit [www.nvosorabotka.gov.mk](http://www.nvosorabotka.gov.mk), në afatin e paraparë (17.11.2021) kanë arritur fletëparaqitje për 4 kandidatë.

Nuk është i plotë dokumentacioni i: Shoqata e qytetarëve për mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave themelore të njeriut, natyrës dhe shoqërisë me theks të qasjes holistike - Bota njerëzore, Shkup (aplikacioni është dorëzuar në mënyrë elektronike, pa nënshkrimin e përfaqësuesit dhe vulën e shoqatë dhe pa kopje të Gjendjes aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, Statutit, Llogarisë përfundimtare për vitin 2020 Raport për punën me qëllimet, aktivitetet, rezultatet dhe burimet e financimit në tre vitet e fundit, Biografi dhe letër motivimi të kandidatit) dhe Shoqata e pensionistve dhe invalidve për komunën e Vrapçishtit, Vrapçishtit (aplikacioni është për anëtar të Këshillit për Zhvillim Ekonomik dhe të Qëndrueshëm dhe një kopje të Gjendjes aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, Statutit, Llogarisë përfundimtare për vitin 2020 Raport për punën me qëllimet, aktivitetet, rezultatet dhe burimet e financimit në tre vitet e fundit, Biografi dhe letër motivimi të kandidatit).

Gjatë verifikimit administrativ të fletëparaqitjeve u përcaktua se fletëparaqitjet e shoqatave në vijim i plotësojnë kushtet e Thirrjes Publike: Lëvizja e ambientalistëve të Maqedonisë - DEM Veles dhe Asociacioni Qendra për Kërkime dhe Informacione Mjedisore EKO-SVEST Shkup.

## II. THIRRJE PUBLIKE PËR VOTIM

**për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të sektorit civil nga radhët e shoqatave dhe fondacioneve për fushën Mbrojtja e mjedisit jetësor**

Thirren të gjitha organizatat aktive të regjistruara në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet. të japin votën e tyre **vetëm për një kandidat, në fushën që është identike me fushën e veprimittë organizatës**, në përputhje me statutin e saj.

Organizatat nuk votojnë për kandidatin nga organizata e tyre.

Votimi kryhet duke plotësuar **Formularin e Votimit**, të disponueshëm në lidhjen vijuese [www.nvosorabotka.gov.mk](http://www.nvosorabotka.gov.mk) dhe duke dorëzuar ekzemplar të **gjendjes aktuale** nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës.

Sindikatat e regjistruara në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet plotësojnë një formular votimi, që llogaritet për një votë të dhënë.

Organizatat mund të mbështesin vetëm një kandidat nga **Lista e Kandidatëve** në vijim.

Numri	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Emri i shoqatës/ fondacionit që propozon kandidat	Biografia dhe letër motivimi
<b>14. Mbrojtje e mjedisit jetësor</b>			
32-48/3	Sashka Kocevka	Lëvizja e ambientalistëve të Maqedonisë - DEM Veles	
32-48/4	Nevena Smilevska	Asociacioni Qendra për Kërkime dhe Informacione Mjedisore EKO-SVEST Shkup	

Për vota të pavlefshme do të llogariten votat e organizatave që nuk janë **aktive** në përputhje me gjendjen aktuale nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, si dhe votat e organizatave që kanë votuar në fushën e veprimittë që nuk është paraparë në statutin e tyre.

Organizatat që realizuan të drejtën e tyre për të votuar në periudhën prej 14 deri më 29.04.2021, ose prej 7 deri më 21.07.2021 ose prej 28.07 deri më 11.08.2021, dhe vota e tyre u konsiderua e vlefshme, nuk kanë të drejtë të votojnë përsëri.

**Afati i votimit është deri më 9.12.2021.**

**Formulari i plotësuar i votimit i nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës dhe i verifikuar me vulën e saj**, me ekzemplar të **gjendjes aktuale** nga regjistrimi në regjistrin e personave të tjerë juridikë për regjistrimin e organizatës, duhet të dorëzohen përmes postës në adresën:

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Sekretariati i Përgjithshëm  
Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare  
bul. " Ilinden" nr.2  
1000 Shkup  
me shënimin: "Mbështetje për kandidat për anëtar të Këshillit".

ose **të skanuara** të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën: [nvosorabotka@gs.gov.mk](mailto:nvosorabotka@gs.gov.mk).

Në afat prej 8 ditëve pas përfundimit të votimit, Sekretariati i Përgjithshëm - Njësia për bashkëpunim me organizatat joqeveritare në faqen e internetit [www.nvosorabotka.gov.mk](http://www.nvosorabotka.gov.mk) do të publikojë Listëne kandidatëve sipas numrit të votave.

Në rast se janë dy kandidatë të renditur të parë, votimi do të përsëritet jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i Listës së Kandidatëve.

[www.nvosorabotka.gov.mk](http://www.nvosorabotka.gov.mk)  
e-mail: [nvosorabotka@gs.gov.mk](mailto:nvosorabotka@gs.gov.mk)



Република Северна Македонија  
Влада на Република Северна Македонија



Организација за соработка со  
интернародни организации по  
генерален секретариат